



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga Ina Rama kryesuese, Natasha Mulaj relatores, Mimoza Tasi, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen nr. 14/2024, datë 12.04.2024, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 737, datë 13.02.2024.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 737, datë 13.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.03.2026.



POSTUAR NGA: NJOFTIME (HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/)

<p>< Njoftim vendimi (https://kpa.al/njoftim-vendimi-405/)</p>	<p>Njoftim vendimi (https://kpa.al/njoftim-vendimi-408/) ></p>
---	---

